



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odrejenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 3653 Më 04.10.2023  
Bf. prot. Dl.  
RAHOVEC - ORAHOVAC



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo  
Komuna Rahovec / Opštine Orahovac / Municipal Rahovec

# Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

RAPORT NËNË-MUJOR I PUNËS

JANAR-SHTATOR 2023

Në kuadër të kompetencave dhe detyrave të drejtorisë, për periudhën janar-shtator 2023, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka realizuar detyrat e saj konform planit të punës për vitin 2023. Synimet e drejtorisë për punë efektive, përgjigje në kërkesat e qytetarëve në një kohë sa më të shpejtë, bashkëpunim me aktorët relevantë për mbrojtje të jetës dhe pronës, intervenim i shpejtë dhe profesional, përmbyllin sukseshëm punën gjatë muajve të DMSH dhe NJPZSH.

Drejtoria për  
Mbrojtje dhe  
Shpëtim

- Gjatë periudhës janar-shtator, janë inspektuar lumenjtë, përrockat dhe kanalet e hapura në të gjithë territorin e Komunës, inspektimi i tillë specifikisht në pikat kyqe ku situatë shihet më e rënduar bëhet disa herë në vit në mënyrë që të eliminohet rreziku për vërshime. Pas incizimit të gjendjes në terren i kemi propozuar drejtorive përkatëse trajtim në ato vende ku ka pasur nevojë për ndërhyrje.
- Kemi bërë inspektimin e rregullt të objekteve publike, private dhe shëndetësore për verifikimin e gjendjes së aparateve për shuarjen e zjarreve. Është kryer servisi i parë për vitin 2023 i aparateve për fikjen e zjarrit në 70 objekte publike të komunës, janë servisuar gjithsej 558 aparate të vendosura në këto objekte: Në objektet e Komunës së Rahovecit dhe zyreve të administratës publike në të gjithë territorin e Komunës, në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, çerdhe, QKMF dhe QMF-të, Shtëpitë e Kulturës, muzetë dhe në palestrenë e sporteve.

- Inspektori për parandalim ka pasur 7 verifikime për dhënie e pëlqimit për mbrojtje nga zjarri për ndërtimin e objekteve dhe 11 dalje për verifikimin dhe hulumtimin e shkaqeve të zjarreve të ndodhura.

- Në këtë nëntë mujor, janë hartuar dy dokumente të rëndësishme:

- Dokumenti mbi rreziqet dhe masat e sigurisë për muajt Korrik dhe Gusht, në të cilën periudhë rreziku për zjarre është tejjet i madh si pasojë e temperaturave të larta.

- Dokumenti për Ngritjen e Gatishmërisë Emergjente për muajt Korrik dhe Gusht për vitin 2023, me të dhënat e dalta nga ky dokument synojmë reagim të shpejtë të NJPZSH-së në mbrojtje të pronës dhe jetës dhe minimizimin e dëmeve që mund të shkaktohen.

- ➔ Është formuar grupi punës për hartimin e Planit Operativ Emergjent, në grupin punës janë të përfshirë të gjithë akterët të cilët në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, mund të kontribuojnë për ti ndihmuar qytetarët dhe minimizuar dëmet që mund të na shkaktohen.

Muaji gusht, u karakterizua më shumë me zjarre kryesisht zjarre të vogla fushore të cilat u lokalizuan dhe u shuan me kohë, falë punës së zjarfikësve nuk kemi pësuar dëme të mëdha në natyrë.

Ekipi i zjarfikësve gjatë nëntë mujorit të vitit 2023, ka marrë gjithsej njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë kërkesa për intervenime, të ndara në kategori të ndryshme të tabelarëve të paraqitur më poshtë:

| Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, strukturës së zjarreve dhe int. ljerë janar-dhjetor 2023 |              |          |         |            |           |           |      |            |           |          |      |     |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|----------|---------|------------|-----------|-----------|------|------------|-----------|----------|------|-----|
|                                                                                                         | Nr. i përgj. | Nr. i    | Nr. i   | Nr. i      | Aksidente | Vërtetime | Të   | Të lënduar | Të vdekur | Gjithsej |      |     |
| 2023                                                                                                    | i daljeve    | zjarreve | Teknike | shërbimeve | mugore    |           | rejs | qj.        | qyt.      | toi      | qyt. | toi |
| Janar                                                                                                   | 8            | 5        | 0       | 1          | 1         | 0         | 0    | 0          | 0         | 0        | 0    | 0   |
| Shkurt                                                                                                  | 17           | 12       | 0       | 5          | 0         | 0         | 0    | 0          | 0         | 0        | 0    | 0   |
| Mars                                                                                                    | 11           | 11       | 0       | 0          | 0         | 0         | 0    | 0          | 0         | 0        | 0    | 0   |
| Prill                                                                                                   | 9            | 4        | 2       | 1          | 2         | 0         | 0    | 0          | 0         | 0        | 0    | 0   |
| Maj                                                                                                     | 11           | 4        | 0       | 5          | 1         | 1         | 0    | 0          | 0         | 0        | 0    | 0   |
| Qershor                                                                                                 | 10           | 4        | 0       | 2          | 0         | 1         | 0    | 0          | 0         | 0        | 0    | 0   |
| Korrik                                                                                                  | 25           | 17       | 2       | 0          | 2         | 0         | 1    | 0          | 0         | 0        | 0    | 0   |
| Gusht                                                                                                   | 51           | 45       | 2       | 2          | 2         | 0         | 0    | 0          | 0         | 0        | 0    | 0   |
| Shtator                                                                                                 | 75           | 70       | 1       | 4          | 0         | 3         | 1    | 0          | 0         | 0        | 0    | 0   |



Më 4 Maj 2023, me një aktivitet simbolik shënuam Ditën Ndërkombëtare të  
Zjarfikësve.



Drejtorinë e Drejtorisë për  
Mbrojtje dhe Shpëtim  
Bashkia e Rahovec



Rahovec  
18/09/2023